



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_, Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_ . \_\_\_\_\_ . 2023

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 5, në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe me aktin nr. 1420 Prot., datë 21.02.2023, referuar nenit 14§2§b të Ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Referuar Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 7818, datë 16.11.2012, “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë të shkallës së parë, të apelit dhe të gjykatave administrative, si dhe caktimin e kompetencave tokësore dhe selisë qendrore të gjykatave administrative”, i ndryshuar, numri i gjyqtarëve në gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit është 389, ndërsa numri i gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë është 19, pra sipas strukturës organizative rezultojnë gjithsej 408 gjyqtarë.

Duke u bazuar në situatën aktuale, në gjykatat e të gjitha niveleve, sipas organikës në fakt, rezultojnë 315 gjyqtarë, nga të cilët:

- 228 gjyqtarë ushtrojnë efektivisht detyrën;
- 62 gjyqtarë të pezulluar dhe paguhen me 75% të pagës (shkarkuar nga KPK);
- 6 gjyqtarë të zgjedhur anëtar në KLGJ-së;
- 2 gjyqtarë të pezulluar nga detyra me vendim të KLGJ-së;
- 6 gjyqtarë me leje (4 raport barrë lindje dhe 2 leje nga KLGJ-ja);
- 11 gjyqtarë të komanduar në detyra të ndryshme, nga të cilët 5 ndihmës magjistrat në Gjykatën e Lartë, 1 komanduar pranë Ministrinë e Drejtësisë, 3 komanduar pranë KLGJ-së dhe 2 komanduar pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Për sa më sipër, në sistemin gjyqësor rezultojnë 93 vakanca të përhershme dhe 87 vakanca të përkohshme.

Sipas vendimit nr. 56, datë 31.01.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së

gjqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” si dhe mbi njoftimin e Shkollës së Magjistraturës, ka filluar procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit si gjyqtar të 40 kandidatëve për magjistratë, profili gjyqtar, që pritet të diplomohen në vitin akademik 2022-2023.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!